

## NË EMER TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: Abdullah Ahmeti, kryetar, Fillim Skoro gjyqtar referues e Xhevdet Abazi, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në lëndën penale ndaj të akuzuarit N.C., nga Pasjani, Komuna e Parteshit, për shkak të veprës penale Marrja ose dhënia e ryshfetit në lidhje me votimin nga neni 215 par.1 të KPRK, duke vendosur përkitazi me ankesën e PTH-DKR në Gjilan, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Gjilan, PKR.nr.47/2014, të dt.23.05.2017, në seancën publike të kolegjit të mbajtur me datën 25.10.2017, mori këtë:

## AKTGJYKIM

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e PTH-DKR në Gjilan dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Gjilan, PKR.nr.47/2014, të dt.23.05.2017, vërtetohet.

## Arsyetim

Gjykata Themelore-DKR në Gjilan me aktgjykimin PKR.nr.47/2014, të dt.23.05.2017, të akuzuarin N.C., në mungesë të provave e në bazë të nenit 364 par.1 nën par.1.3 të KPP, e liron nga akuza për shkak se nuk është vërtetuar se ka kryer veprën penale Marrja ose dhënia e ryshfetit në lidhje me votimin nga neni 215 par.1 të KPRK.

Shpenzimet e procedurës penale, bien në barrë të mjeteve buxhetore të asaj gjykate.

Kundër këtij aktgjykimi me kohë ka ushtruar ankesë:

-PTH-DKR në Gjilan, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par.1.12 të KPP dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit, që ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta anuloj dhe lëndën ta kthej në rigjykim dhe vendim.

Prokuroria e Apelit-DKR në Prishtinë, me shkresën e saj, PPA/I.nr.424/17, të dt.27.09.2017, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e PTH-DKR në Gjilan, ka propozuar që ankesa e PTH-DKR në Gjilan, të aprovet si e bazuar.

Gjykata e Apelit, konformë nenit 390 par.1 të KPP, nuk caktoi seancë të kolegjit, për arsye se kemi të bëjmë me aktgjykim lirues dhe caktimi i seancës së kolegjit nuk është i domosdoshëm.

Gjykata e Apelit, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPP, vlerësoi pretendimet ankimore të PTH-DKR në Gjilan si dhe të sqarimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit, si dhe shqyrtoi shkresat e lëndës dhe gjeti se:

Ankesat e PTH-DKR në Gjilan është e pabazuar.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës.

PTH-DKR në Gjilan në ankesën e saj pretendon se aktgjykimi është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par.1.12 e në lidhje me nenin 370 të KPP, për arsye se dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me bracinë e tij dhe me arsyet e paraqitura lidhur me faktet vendimtare, e si pasojë e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë.

Në ankesë pretendohet se i dëmtuari dëshmitari T.Zh., gjatë hetimeve ka deklaruar se së bashku me Z.P.in dhe me një person tjetër i akuzuari N.C., ka qenë në shtëpinë e tij dhe me atë rast i akuzuari ka kërkuar letërnjoftimet e familjarëve të tij, duke i thënë që të nesërmen mos të dalë në zgjedhje me pretendim se fitorja është e tij dhe të mos e përçajë popullin serb dhe i akuzuari ka lënë një kartëmonedhë prej 50Euro, mbi kanaqe përkundër kundërshtimit të tij. Në mënyrë të ngjashme ka deklaruar dëshmitari N.T., se i akuzuari N.C., me personin Z.P., i akuzuari ka bërë trusni që të votoj subjektin politik "SLS", meqenëse i ka ndërtuar shtëpinë e tij dhe se ka qenë i kthyer nga Serbia, përndryshe nëse nuk e voton do të rrezikohet edhe jeta e tij. Edhe dëshmitari B.B., ka deklaruar në hetime se ka ardhur në shtëpinë e tij i akuzuari Nenad, i shoqëruar me dëshmitarin Z.P. dhe një person tjetër që ngjasonte të jetë me uniformë policore të cilit i ka treguar se një natë më parë është kërcënuar nga dy persona të pa njohur që mos të dalë në zgjedhje dhe do të ketë problem meqë djalin e ka në studime në Mitrovicë dhe mund ti ndodhë e keqja, ndërsa në shqyrtimin gjyqësor të gjithë dëshmitarët kanë ndryshuar deklaratat e tyre të dhëna në hetuesi.

Gjykata e Apelit, në pajtim me nenin 394 par.1 të KPP, duke e shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën e PTH-DKR në Gjilan, e sipas detyrës zyrtare, në kuptim të shkeljes së ligjit penal, nga neni 385 par.1 të KPP, Gjykata e Apelit, gjen se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është përfshirë në shkeljet e cekura më lartë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Gjykata e Apelit pretendimet ankimore të PTH-DKR në Gjilan, të cilin aktgjykimin e ankimuar e ankimon për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vlerëson se pretendimet ankimore të paraqitura në ankesë, janë të pabazuara. Gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe të argumentuara lidhur me lirimin e të akuzuarit N.C., nga akuza për shkak se nuk është provuar se i akuzuari të ketë kryer veprën penale Marrja ose dhënia e rryshfetit në lidhje me votimin nga neni 215 par.1 të KPRK, për arsye se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila ka qenë objekt i akuzës.

Gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të qarta dhe të plota lidhur me faktet vendimtare se i akuzuari N.C., nuk ka kryer veprën penale Marrja ose dhënia e ryshfetit në lidhje me votimin nga neni 215 par.1 të KPRK, kjo se gjatë shqyrtimit gjyqësor dëshmitarët T.Zh., N.T. dhe B.B., të gjithë në mënyrë të prerë kanë deklaruar se ndaj tyre është ushtruar presione të llojeve të ndryshme përmes telefonit nga pjesëtar të listës Serbe dhe të njëjtit janë kanosur se atyre do t'iu ndalen edhe ndihmat sociale të cilat i kanë marrë nga shteti i Serbisë, e duke ditur se ata të gjithë janë shfrytëzues të ndihmës sociale, dhe dëshmitari T.Zh., në shqyrtimin gjyqësor mohon se i akuzuari N.C., në kohën e heshtjes parazgjedhore i akuzuari N.C. t'ia ketë kërkuar i akuzuari letërnjoftimet por edhe ti ketë dhënë 50 Euro dhe këtë deklaratë në hetuesi e ka dhënë, t'iu ndalen edhe ndihmat sociale të cilat i kanë marrë nga shteti i Serbisë i cili edhe vetë ka qenë shfrytëzues i ndihmës sociale e cila ka qenë minimale, edhe dëshmitarit N.T., në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se ka qenë në ndikimin e presioneve të listës serbe dhe deklaratat të cilat i ka dhënë në hetuesi për të akuzuarin N.C., i ka dhënë në trysnin e listës serbe, e ngjashëm ka deklaruar edhe dëshmitari B.B., se deklarata është dhënë në hetuesi nën presionin e listës serbe.

Nga këto dëshmi të nxjerra në shqyrtimin gjyqësor e të cilat dëshmi janë identike lidhur me atë se lista serbe, ka bërë trusni te dëshmitarit T.Zh., N.T. dhe B.B., e cila listë ka qenë direkt e lidhur me pushtetin serb që me çdo kusht të votohet lista serbe, gjykata ka nxjerrë përfundime dhe konkludime të drejta lidhur me faktet vendimtare se me asnjë provë të vetme nuk është provuar se i akuzuari N.C., në këtë çështje penale të ketë marrë ryshfet e në lidhje me votimet të cilat janë mbajtur për kryetar të Kuvendeve Komunale, për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës dhe nga shkresat e lëndës dhe provave të nxjerra në shqyrtimin gjyqësor, e në të cilat bazohet edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, pretendimet ankimore të PTH-DKR në Gjilan, se aktgjykimi është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nuk qëndrojnë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë drejtë në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar edhe gjendjen faktike dhe ka dhënë arsye të plota dhe bindëse dhe nga provat materiale e nga dëshmitë e dëshmitarëve T.Zh., N.T. dhe B.B., në mënyrë të plotë është vërtetuar se lista serbe, përmes pushtetit të Serbisë të dirigjuar nga Beogradi, ka bërë trusni te dëshmitarët që në zgjedhjet lokale të cilat janë mbajtur në vitin 2013, të mos votohet për kryetar të Komunës së Parteshit i akuzuari N.C., i cili ka qenë kandidatë i subjektit politik "GIS". Nga deklaratat e dëshmitarëve të cilët janë cekur më lartë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale në mënyrë të qartë dhe të plotë janë dhënë fakte vendimtare e bashkë me këtë edhe në mënyrë të drejtë e të plotë është vërtetuar gjendja faktike dhe gjykata ka nxjerr përfundime të drejta dhe të qarta, se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari N.C., të ketë kryer veprën penale dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimet nga neni 215 par.1 të KPRK, e në këtë çështje penale kemi të bëjmë se kinse i akuzuari N.C., i ka dhënë 50 Euro, në kohën e heshtjes parazgjedhore për kandidat të Komunës së Parteshit, që janë mbajtur me dt.15.12.2013 dhe të ketë shkuar te shtëpia e të dëmtuarit T.Zh. dhe nga ai të ketë kërkuar që me familjarët e tij të mos dalin në zgjedhje, duke ditur se është pjesëtar i subjektit politik "GIS" dhe për këtë kinse atij i ka dorëzuar në emër të dhënies së ryshfetit kartëmonedhën prej 50 Euro, e duke e lënë mbi kanaqe dhe nga i dëmtuari T.Zh., ka kërkuar që të dorëzoj të gjitha letërnjoftimet e bashkëshortes së tij dhe të tre fëmijëve, të tij, e të cilat fakte në shqyrtimin gjyqësor me asnjë provë nuk janë vërtetuar e të cilat në tersi i ka mohuar dëshmitari T.Zh. e cila deklaratë është dhënë në trysni dhe iu janë kanosur se atyre do t'iu ndalen edhe ndihmat sociale të cilat i kanë marrë nga shteti i Serbisë, e duke ditur se ata të gjithë janë shfrytëzues të ndihmës sociale si dhe vet dëshmitari.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejta ka vepruar kur të akuzuarin e ka liruar nga akuza për arsye se nuk është provuar që i njëjti të ketë kryer veprën penale për të cilën ka qenë edhe i akuzuar.

Gjendja e këtillë faktike siç rezulton nga shkresat e lëndës e cila është vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë, është e pranueshme edhe për Gjykatën e Apelit, dhe pretendimet ankimore se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e të pretenduara në ankesë e PTH-DKR në Gjilan, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit janë të pa bazuara.

Si u cekë edhe më lart u deshtë që ankesa e PTH-DKR në Gjilan të refuzohet si e pa bazuar dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet e në bazë nenit 401 të KPP.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.444/2017, me dt.25.10.2017**

**Procesmbajtës,**

**Eroll Gashi**

**Anëtarët e Kolegjit,**

**Fillim Skoro**

**Xhevdet Abazi**

**Kryetari i Kolegjit,**

**Abdullah Ahmeti**